



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

**THIRRJE PËR APLIKIM PËR BURSA NGA MINISTRIA E ARSIMIT, RINISË
DHE SPORTIT TË REPUBLIKËS ÇEKE NË PROGRAMIN E SHKOLLËS
VERORE PËR STUDIMET SLLAVE 2025**

Ambasada e Republikës së Çekisë njofton se Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sportit të Republikës Çeke ofron 2(dy) bursa në programin e Shkollës Verore për Studimet Sllave, 2025. Studentët shqiptarë, mbi 18 vjeç, specialistë ose akademikë që studiojnë gjuhën çeke, si dhe të gjithë ato që janë të interesuar për gjuhën dhe kulturën çeke, janë të ftuar të marrin pjesë. Kurset janë të përgatitur për fillestarë, me njohuri të ndërmjetme dhe të avancuara në gjuhën çeke.

- **Bursa e parë** ofrohet nga **Universiteti Charles në Pragë** (17 korrik - 14 gusht 2025).
- **Bursa e dytë** ofrohet nga **Universiteti Masaryk në Brno** (26 korrik - 23 gusht 2025).

Institucionet pritëse çeke mbulojnë shpenzimet për regjistrimin, tarifën e kursit, akomodimin, ushqimin dhe aktivitetet kulturore.

Një informacion i detajuar rreth formës së aplikimit dhe dokumentave të tjerë gjendet në faqen online të Ministrisë së Arsimit, Rinisë dhe Sportit të Republikës Çeke: <https://msmt.gov.cz/eu-and-international-affairs/summer-schools-of-slavonic-studies-2025?lang=2>

Kandidatët e interesuar për kurset e mësipërme duhet të dërgojnë në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, nëpërmjet postës, brenda datës 7 mars 2025, dokumentacionin përkatës sipas listës në vijim:

- Kërkesën për ndjekjen e kursit veror të gjuhës çeke e firmosur nga vetë personi, ku të vendoset adresa elektronike dhe numri i telefoni;
- Formularin e aplikimit <https://msmt.gov.cz/file/64197>;
- Kopjen e noterizuar të diplomës;
- Kopjen e noterizuar të listës së notave;
- Fotokopjen e faqes së pasaportës me të dhënat e identitetit;
- 2 (dy) fotografi;
- CV në anglisht.

DREJTORIA E INTEGRIMIT, KOORDINIMIT, MARRËVESHJEVE DHE ASISTENCËS